

DHUNA ME BAZË GJINORE

**Ndërgjegjësimi dhe Parandalimi i saj nëpërmjet
edukimit jo-formal në punën me të rinjtë**



Përgatitur nga:



Me mbështetjen e:



Tiranë, 2020

PËRMBAJTJA

04

HYRJE

06

ÇFARË KONSIDEROHET
DHUNË ME BAZË GJINORE?

07

CILAT JANË FORMAT E
DHUNËS ME BAZË GJINORE?

09

CILAT JANË FORMAT E
DHUNËS ME BAZË GJINORE?

11

BARRIERAT PËR RAPORTIMIN E
DHUNËS ME BAZË GJINORE:

12

PASOJAT E DHUNËS ME
BAZË GJINORE

13

DHUNA ME BAZË GJINORE
NË MARRËDHËNIET INTIME

13

SI TË REAGOJMË NDAJ
DHUNËS ME BAZË GJINORE?

14

AKTIVITETE PRAKTIKE
METODA TE EDUKIMIT JO
FORMA

19

MESAZHE NGA TE RINJTE

"Ju mund ta falni partnerin tuaj për gabimet që ata bëjnë, por asnjë person nuk duhet të pranojë asnjë formë abuzimi nga partnerët e tyre pa marrë parasysh sesa pasionante apo sesa e fortë është dashuria. Pavarësisht se sa vite është marrëdhënia. Askush nuk duhet të tolerojë abuzimin."

Punuar nga:

**Oltiana Rama
Harold Koxha**

Parathënie

Dhuna me bazë gjinore është një fenomen i cili shqetëson komunitetet ku ne jetojmë prej shekujsh. Ky fenomen ka pasoja të ashpra mbi viktimat por edhe në të gjithë komunitetin në periudhë afat-gjatë dhe afatshkurtër. Ajo kërkon një përgjigje shumë-dimensionale dhe gjithësecili prej nesh ka një përgjegjësi për të kontribuar në minimizimin e saj.

Parandalimi i dhunës me bazë gjinore lidhet fortë me ndërgjegjësimin e shoqërisë në tërësi dhe për më tepër të fëmijëve dhe të rinjve. Cdo profesionist i cili bie në kontakt me të rinjtë duhet të ketë në fokusin e vet mënyra sesi mund të kontribuojë në formësimin e një mentaliteti pa dhunë tek ata.

Ky manual ka për qëllim të paraqesë konceptet kryesore mbi dhunën me bazë gjinore dhe të njohë disa nga metodat sesi mund ky fenomen mund të parandalohet dhe trajtohet nëpërmjet edukimit jo-formal në punën me të rinjtë.

Hyrje

Aktet e dhunës me bazë gjinore janë ndër format më të zakonshme të dhunës në shumë vende dhe vlerësohet se ndikojnë në jetën, shëndetin dhe mirëqenien e miliona grave, vajzave, djemve dhe burrave në të gjithë botën. Dhuna me bazë gjinore ndodh në mbarë vendet e botës, por shoqëritë të cilat kanë një koncept të ngurtë mbi rolet gjinore mund të jenë më të riskuara. Gjithsesi shkalla e përparimit të një shoqërie nuk përcakton përfundimisht ekzistencën ose jo të dhunës me bazë gjinore dhe kështu ky fenomen i cili shkakton pasojat afatgjata e të rënda në shëndetin dhe mirëqenien e personave, mund të haset çdo shoqëri

Në shumë kultura, dhuna ndaj vajzave dhe grave të reja pranohet si një normë shoqërore. Kjo duhet të trajtohet si një çështje urgjente, dhe turpi, faji apo stigmatizimi me të cilat përballen viktimat duhet të eliminohet.

Aktet e dhunës me bazë gjinore janë ndër format më të zakonshme të dhunës në shumë vende dhe vlerësohet se ndikojnë në jetën, shëndetin dhe mirëqenien e miliona grave, vajzave, djemve dhe burrave në të gjithë botën. Dhuna me bazë gjinore ndodh në mbarë vendet e botës, por shoqëritë të cilat kanë një koncept të ngurtë mbi rolet gjinore mund të jenë më të riskuara. Gjithsesi shkalla e përparimit të një shoqërie nuk përcakton përfundimisht ekzistencën ose jo të dhunës me bazë gjinore dhe kështu ky fenomen i cili shkakton pasojat afatgjata e të rënda në shëndetin dhe mirëqenien e personave, mund të haset çdo shoqëri.

Sipas Martin, Zia & Soler (1998) dhuna me baze gjinore konsiderohet një epidemi globale që ndikon shëndetin dhe shumë-dimensional të grave, të familjeve dhe komunitetit ku ato bëjnë pjesë. Përpyekjet ndërkombëtare për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore kanë pësuar rritje të ndjeshme gjatë dekadës së fundit. Kjo është e lidhur me faktin se bota në përgjithësi ka qenë dëshmitare e numrit në rritje të grave të dhunuara në kërkim të një vendi të sigurtë jashtë mjedisit të dhunshëm të familjes[1].

Dhuna me bazë gjinore ushqehet kryesisht nga norma e pabarabarta gjinore!

Në kontekstin Shqipëtar DhBGj [2] nuk është një fenomen i ri. Duke konsideruar traditat dhe zakonet patriarkale në vendin tonë mund të themi se ajo ka qenë prezente hershëm në shoqërinë e Shqipërisë. Disa nga zakonet dhe mëndësitë tradicionale të vendit tonë, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, dhunuesit patriarkalë, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit, zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes dhe kontrollin midis brezave në familje, mund të na tregojnë se DhBGj ka rrënjë të thella në shoqërinë tonë.

[1] Shehu dhe Gramo (2011)- DHUNA ME BAZË GJINORE; MANUAL PËR PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË

[2] DHUNA ME BAZË GJINORE

Ky fenomen ndikon te njerëzit në pika të ndryshme të jetës së tyre duke marrë forma të ndryshme të ushtrimit të saj. Format e DhBGj mund të përfshijë dimensione fizike, seksuale dhe psiko-emocionale. DhBGj drejtohet mund të drejtohet edhe ndaj djemve dhe burrave por shumica dërrmuese e rasteve përfshijnë dhunën ndaj grave dhe vajzave. Dhuna me bazë gjinore konsiderohet tanimë nga shumë institucione, agjenci dhe organizma ndërkombëtare që punojnë për trajtimin e këtij fenomeni si një problematikë e shëndetit, zhvillimit global dhe mbi të gjitha si një prioritet i shërbimeve të përkujdesjes sociale dhe shëndetësore.

Në këtë kuadër gjithnjë e më shumë dhuna me bazë gjinore është duke u adresuar përmes rregullimeve të reja ligjore, krijimit të politikave për mbrojtje, zhvillimit të programeve që synojnë reduktimin e DhBGj apo forcimit të mekanizmave që trajtojnë këtë cënim të rëndë të drejtave të njeriut.

Shifrat e DhBGj janë tronditëse bazuar në studimet e shumta të besueshme që janë kryer në vende të ndryshme të botës. Sipas OBSH[3] (2017), 1 në 3 gra dhe vajza të cilat kanë qënë në një lidhje afektive, në mbarë botën, ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale nga parteri intim që është përfshirë në marrëdhënie seksuale dhe/ose marrëdhënie joseksuale. Sipas iNSTAT (2018)[4], në Shqipëri 1 në 2 gra dhe vajza ka përjetuar dhunë (dhunë nga partneri intim, dhunë gjatë marrëdhënies dashurore, dhunë na jopartneri, ngacmim seksual ose përndjekje).



[3] Organizata Botërore e Shëndetësisë

[4] VROJTIM KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN 2018
Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
në Shqipëri

Çfarë konsiderohet Dhunë me Bazë Gjinore?

Shpesh shihet e vështirë për të dhënë një përkufizim të vetëm për DhBGj. Megjithëse ekzistojnë shumë përkufizime, në një këndvështrim të përgjithshëm dhuna me bazë gjinore përcaktohet si dhuna që drejtohet kundër një personi për shkak të gjinisë ose seksit të tij/saj, duke përfshirë veprime që shkaktojnë dëmtim fizik, mendor ose seksual ose vuajtje, kërcënime, shtrengim dhe privime të lirisë. Ajo përfshin dhunë fizike, seksuale dhe psikologjike të kryer brenda familjes, marrëdhënieve mes partnerëve, komunitetit të përgjithshëm ose nga shteti dhe institucionet publike.

Në deklaratën “Për Eliminimin e Dhunës Ndaj Gruas”[5], bërë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, e ka përkufizuar dhunën me baze gjinore si: “...një akt të bazuar në përkatësinë gjinore, që rezulton ose mund të rezultojë me lëndime fizike, seksuale, psikologjike apo vuajtje afatgjata të grave, përfshirë kërcënime e akte të ngjashme, detyrime apo nëvlerësime arbitrare, që ndodhin në jetën personale ose publike”.

Një tjetër përcaktim për dhunën ndaj gruas është dhënë në Konventën e Eliminimit të Diskriminimit Ndaj Gruas (CEDAW) duke e emërtuar dhunën si “... një manifestim i marrëdhënieve historikisht jo të barabarta mes burrave dhe grave”, dhe cilësuar dhunën si “... një mekanizëm kryesor nga i cili gratë janë detyruar të qëndrojnë në një pozicion më të ulët, krahasuar me burrat”.




[5] Deklarata mbi Eliminimin e Dhunës ndaj Grave- Kombet e Bashkuara (1993)

Cilat janë format e Dhunës me Bazë Gjinore?



Dhuna seksuale

Përfshin aktet e kryera apo të tentuara për përdhunim, (vaginal, anal ose oral), përfshirë edhe kur ato ndodhin në kontekstin e një marrëdhënie martesore; abuzimin dhe shfrytëzimi seksual; prostitucion i detyruar; kërcënimet, poshtërimet apo ngacmimet seksuale. Gjithashtu dhuna seksuale manifestohet sa herë që kryhen veprime apo marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e njërës palë, detyrimin për të kryer marrëdhënie seksuale me të tjerë ose për të parë të tjerë duke kryer marrëdhënie seksuale, si dhe kryerja e veprimeve seksuale të cilat e bëjnë një person të mos ndjehet rehat.





Dhuna fizike

Përfshin aktet e kryera me dashje për të shkaktuar lëndim apo dëmtim trupor ndaj një personi tjetër. Kjo formë e dhunës manifestohet nëpërmjet ccdo kontakti fizik të padëshiruar si shtyrje, goditja me shuplakë, kafshimi apo hedhja e sendeve të forta mbi një person. Gjithashtu përfshihet kërcënimi, kyçja në një vend të shtëpisë apo jashtë saj, lënia në një vend të rrezikshëm apo edhe refuzimi i dhënies së ndihmës në momente kur një person është i dëmtuar.



Dhuna psikologjike dhe emocionale

Përfshin abuzimin dhe poshtërimin, të tilla si fyerjet; trajtim mizor dhe degradues; detyrimin e një person të përfshihet në veprime poshtëruese; dhe vendosja e kufizimeve të lirisë apo mundësisë së lëvizjes.



Dhuna socio-ekonomike

Përfshin diskriminimin dhe mohimin e mundësive ose shërbimeve të barabarta për shkak të seksit, gjinisë ose orientimit seksual; perjashtim social; praktika ligjore penguese, të tilla si mohimi i ushtrimit dhe gëzimi i të drejtave civile, sociale, ekonomike, kulturore dhe politike, kryesisht ndaj grave dhe vajzave.

Praktikat dëmtuese tradicionale

Praktikat dëmtuese tradicionale Përfshini gjymtimin/prerjen gjenitale të femrave; martesat e detyruara; martesat në moshë fëmijore; praktikat e abortit selektiv; neglizhenca dhe abuzimi si pasojë e përzgjedhjes së gjinisë; dhe mohimi i arsimit dhe mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat.

Kush janë viktima të Dhunës me Bazë Gjinore?

Dhuna me bazë gjinore nuk njeh moshë, gjini apo prejardhje!

Pavarësisht dhuna me bazë gjinore prek në mënyrë disproporcionale gratë dhe vajzat edhe burrat dhe djemtë shpesh janë në shënjestër gjithashtu. Sidoqoftë, gratë dhe burrat mund të përballen me forma të ndryshme të dhunës.

Kush janë kryesit e dhunës me bazë gjinore?

Kryerësit më të zakonshëm të dhunës me bazë gjinore përfshijnë: familjen, miqtë, bashkëmoshatarët dhe fqinjët, të panjohurit, partnerët intimë, klientët e marrëdhënieve seksuale dhe punëtorët e tjerë të seksit, punonjësit e kujdesit shëndetësor, policinë, udhëheqësit fetarë dhe mësuesit.



Cilat janë format e Dhunës me Bazë Gjinore?

Adresimi që mund t'i bëhet DhBGj duhet të nisë gjithmonë nga evedentimi i rrënjeve dhe faktorëve nxitës që ndikojnë në këtë fenomen. Trajtimi i këtyre faktorëve është një element kyç për të parandaluar dhe ulur shpeshhtësinë e këtij krimi.

Mund të themi se shkaqet rrënjësore të të gjitha formave të DhBGj qëndrojnë në qëndrimet e një shoqërie dhe praktikave ndaj diskriminimit gjinor. Dhuna me bazë gjinore është e rrënjësuar thellë në bindjet dhe qëndrimet kulturore diskriminuese që përjetësojnë pabarazinë dhe pafuqinë, në veçanti të grave dhe vajzave. Faktorë të ndryshëm të tjerë, të tilla si varfëria, mungesa e arsimit dhe mundësive të jetesës, dhe mosndëshkimi i krimve dhe abuzimeve, gjithashtu priren të kontribuojnë dhe të forcojnë një kulturë dhune dhe diskriminimi bazuar në gjini.

Faktorë të tillë shpesh keqësohen në kohë konfliktesh apo krizash socio-ekonomike të një vendi. Rezultati është shpesh një rritje si në frekuencën, ashtu edhe në brutalitetin e dhunës me bazë gjinore. Adresimi i shkaqeve rrënjësore përmes veprimtarive parandaluese kërkon qëndrueshmëri, plane veprimi afatgjatë, me ndryshime që ndodhin ngadalë për një periudhë të gjatë kohore.

Faktorët

- Mungesa e sigurisë fizike për shkak të kolapsimit së rendit dhe ligjit, prania e forcave / grupeve të armatosura, mos-funksionimi i zbatimit të ligjit, institucioneve të drejtësisë, strukturave shoqërore ose të komunitetit;
- Ligjet, normat kulturore ose fetare dhe praktikat diskriminuese shoqërore që marginalizojnë gratë dhe vajzat dhe nuk respektojnë të drejtat e tyre;
- Varfëria, mungesa e arsimit dhe kushteve optimale të jetesës. Në këtë kontekst mund të përmendim qasjen joadekuate në strehim, ushqyerje dhe në gjenerimin e të ardhurave të cilat mund të rrisin ekspozimin ndaj DhBGj, duke përfshirë prostitucionin e detyruar ose marrëdhënieve seksuale për të mbijetuar;
- Mungesa e besimit në institucionet shoqërore ose publike, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë që dekurajojnë viktimat/të mbijetuarit të kërkojnë ndihmë apo të raportojnë dhunën;
- Mungesa e qasjes në institucionet dhe mekanizmat e mbrojtjes apo të drejtësisë, duke rezultuar në kulturën e mosndëshkimit për dhunën dhe abuzimin;
- Kërcënimi ose frika e stigmës, izolimit dhe përjashtimit shoqëror;
- Mungesa e informacionit në lidhje me të drejtat e njeriut dhe se si dhe ku të kërkohet ndihmë;
- Mungesa e ndërtimit të programve dhe shërbimeve me qasje të ndjeshme gjinore;
- Mungesa e mbrojtjes ligjore parësore dhe dytësore të përballueshme ose falas nga për persona në vështirësi ekonomike;
- Mungesa e mekanizmave të përshtatshëm të mbrojtjes së viktimave/të mbijetuarve apo dëshmitarëve;
- Mungesat e një kuadri ligjor të përshtatshëm, që dështon të mbrojë gratë dhe vajzat nga diskriminimi, nuk garanton të drejtat e tyre, ose i ekspozon ato ndaj dëmtimeve dhe abuzimeve të mëtejshme.

Gjithashtu është e rëndësishme të pranohet që dhuna me bazë gjinore mund të normalizohet dhe riprodhohet për shkak të pabarazive strukturore, siç janë normat shoqërore, qëndrimet dhe stereotipet rreth gjinisë në përgjithësi dhe dhuna ndaj grave në veçanti.

Prandaj është e rëndësishme të pranojmë dhunën institucionale, e cila mund të përkufizohet si vartësia e grave në jetën ekonomike, shoqërore dhe politike, kur përipiqemi të shpjegojmë përhapjen e dhunës ndaj grave brenda shoqërisë tonë.

Barrierat për raportimin e Dhunës me Bazë Gjinore:

Duhet pranuar se dhuna me bazë gjinore është një krim i cili nën raportohet. Në heshtjen ndaj dhunës me bazë gjinore sigurisht që ndikojnë shumë faktorë të cilët sa herë janë shumë individual dhe shpesh herë janë të ngjashëm për shumë prej viktimave. Stigma shoqërore që lidhet me këtë fenomen bën që shumë prej grave dhe vajzave të dhunuara për shkak të gjinisë së tyre të mos raportojnë asnjëherë dhe të vuajnë në heshtje pasojat e këtij krimi. Disa nga arsytet e tjera që i shtyjnë viktimat të mos raportojnë listohen si më poshtë:

- Gratë dhe vajzat e dhunuara mund të shqetësohen se zbulimi i dhunës mund të manipulohet apo të mos besohet nga të personat që ato mund të kërkojnë ndihmë;
- Shpesh herë viktimat e dhunës me bazë gjinore mund të fajësojnë veten e tyre për ngjarët që ndodhin. Kështu ato pranojnë dhunën duke mbartur ndjenjat e fajësisë mbi vete;
- Dhuna me bazë gjinore shpesh mund të shkaktojë ndjenjat e turp-it tek viktimat pasi abuzuesi mund të jetë një person i afërm apo i besuar. Kështu ato rezistojnë të raportojnë duke i mbajtur aktet e dhunës si një sekret brenda mjedisit të tyre familjar.
- Sipas shumë evidencave dhuna me baze gjinore shkaktohet nga persona të afërt të viktimave. Duke mos dashur që këta persona të ndëshkohen, viktimat në disa raste nuk preferojnë të raportojnë.

- Shumë gra dhe vajza janë të kërcënuara, manipunuara ose të frikësuara për të raportuar dhunën që mund të ushtrohet ndaj tyre. Agresorët shpesh përdorin kërcënimet për të mbajtur në heshtje viktimat e tyre;
- Në shumë kontekste vajzat dhe gratë kanë pasigurinë për të raportuar dhunën që mund të ushtrohet ndaj tyre duke pasur frikë nga paragjykimet shoqërore. Mjedisi shoqëror mund të paragjykojë duke mbajtur qëndrime fajësuese ndaj viktimave të dhunës me bazë gjinore;
- Viktimat e dhunës me bazë gjinore janë skeptikë ndaj ndihmës që mund të marrin pasi raportojnë. Kështu gratë dhe vajzat mund të kenë frikë, se një zbulim i dhunës mund të sjellë pasoja negative (p.sh. abuzim ose dhunë të mëtejshme, shqetësime në familje, trajtim jo i duhur nga personat që do t'i tregojë për dhunën seksuale, ekspozim në publik si viktimë e dhunës;



Pasoja e Dhunës me Bazë Gjinore

Dhuna me bazë gjinore mund të ketë pasoja serioze afatgjata dhe të rrezikshme për jetën e viktimave/të mbijetuarve. Këto pasoja mund të variojnë nga shkaktimi i paaftësive e përhershme ose vdekjes deri në një larmi të problemeve fizike, psiko-sociale dhe shëndetësore që shpesh shkatërrojnë vetëvlerësimin dhe cilësinë e jetës së të mbijetuarive ose e ekspozojnë atë në abuzime të mëtejshme. Dhuna me bazë gjinore mund të çojë në një cikël të egër dhune dhe abuzimi pasi të mbijetuarit rrezikojnë të refuzohen nga familja e tyre, të përjashtohen dhe dëbohen nga shoqëria, madje të arrestohen, ndalohen ose ndëshkohen dhe donjëherë të abuzohen përsëri kur janë në kërkim të mbrojtjes, ndihmës dhe drejtësisë.

Pasoja fatale:

- Vrasje
- Vetë-vrasje
- Vdekje të nënave
- Vdekje e Fëmijëve

Pasoja Emocionale dhe Psikologjike

- Stresi post-traumatik
- Depresioni
- Zemërimi, ankthi dhe frikë
- Turp, urrejtja ndaj vetes dhe vetëfajësimi
- Çrregullime psikologjike
- Mendime dhe sjellje vetëvrasëse;
- Pasoja Sociale dhe Ekonomike
- Fajësimi i viktimës / të mbijetuarit

Pasoja Fizike dhe Shëndetësore:

- Lëndime ose dëmtime fizike
- Tronditje
- Sëmundje ose Infeksione
- Sëmundje dhe Infeksione Seksualisht të Transmetueshme;
- Aftësi të Kufizuar
- Dhimbje kronike
- Probleme gastrointestinale;
- Çrregullimet e të ngrënit ose të gjumit

Pasoja Riprodhuese:

- Aborti spontan
- Shtatzënia e padëshiruar
- Aborti i pasigurt
- Çrregullimet menstruale
- Komplikacione të shtatzënisë
- Çrregullime gjinekologjike
- Çrregullime seksuale

- Humbja e roleve ose funksioneve në shoqëri
- Stigma sociale, refuzim dhe izolim
- Feminizimi i varfërisë
- Rritja e pabarazive gjinore
- Humbja e pavarësisë ekonomike
- Arrestimi, ndalimi dhe / ose ndëshkimi

Dhuna me Bazë Gjinore në marrëdhëniet intime

Ky lloj i dhunës me bazë gjinore është një ndër më të zakonshmet që ndodhin. Gjithashtu është tepër e vështirë që ajo të raportohet duke qënë së abuzuesit mund të kenë një pozicion besimi dhe kontrolli mbi viktimat.

Në raste të tjera shumë gra dhe vajza janë jo të ndërgjegjësuar mbi dhunën që ushtohet mbi to duke e pranuar si diçka normale. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme që të njihen disa nga shenja e para që tregojnë së një grua apo vajzë është duke përjetuar dhunë me bazë gjinore nga partneri intim dhe të jetë e ndërgjegjshme se kjo situatë duhet të ndryshojë.

Më poshtë jepen disa nga shenjat paraprake të cilët janë treguese për dhunën me bazë gjinore. Ato nuk duhet të pranohen por të ngrihet zëri për t'i thënë ndalo.

- Kur partneri ngul këmbë të heqësh dorë nga dëshirat dhe ëndrrat e tua
- Kur partneri nxehet shpejt dhe ka një humor të paqëndrueshëm
- Kur janë prezente histori të mëparshme të dhunës dhe abuzimit me substancat
- Kur partneri është posesiv dhe xheloz
- Kur partneri është gjithmonë duke ju kontrolluar
- Kur partneri insiston të hyjë në një marrëdhënie që ju nuk jeni ende gati
- Kur partneri ju bën të ndjeheni shpesh në tension dhe gjithmonë justifikon sjelljet e pahijshme
- Kur ndjehet superior ndaj të tjerëve apo ndaj jush

Si të reagojmë ndaj dhunës me bazë gjinore?

Dhuna nuk është çështje private! Pasojat e saj përkin të gjithë komunitetin dhe duhet të raportohet në mënyrë që të trajtohet. Eliminimi i dhunës me bazë gjinore do të përfshijë veprime në të gjitha nivelet: sfidimin e normave shoqërore që mohojnë dhunën ose imponojnë role gjinore; forcimi i legjislacionit për kriminalizimin e dhunës dhe ndjekja penale e autorëve të krimit.

Gjithashtu secili nga ne mund të jetë dëshmitar i dhunës me bazë gjinore në jetën tonë të përditshme. Për këtë arsye ne duhet të njohim disa nga mënyrat sesi mund të reagojmë ndaj saj. Kur një viktimë zgjedh të komunikojë me ju për dhunën që është duke përjetuar kjo do të thotë që është e nevojshme të mbështetet në mënyrën e duhur dhe të orientohet për të marrë ndihmë.

Disa nga mënyrat sesi mund të qasemi ndaj një viktime të dhunës me bazë gjinore janë si mëposhtë:

- Lejoni viktimës t'ju qaset ju dhe dëgjoni në mënyrë aktive nevojat e tyre;
- Pyesni sesi viktima mendon se ju mund ta ndihmoni me për nevoja urgjente bazike. Disa viktima mund të kenë nevojë për ndihmë të menjëhershme mjeksore apo veshje;
- Pyesni nëse viktima ndjehet komod për të biseduar me ju në vendodhjen aktuale në të cilën ndodheni;
- Ofroni mbështetje me gjëra praktike si ushqim, ujë, një vend për t'u ulur, façoleta etj.
- Merrni rolin e dëgjuesit. Jepini kohë viktimës të flasë dhe lejoni ato të tregojnë në ritmin e tyre.
- Trajtoni çdo informacion të marrë gjatë bisedës me konfidencialitetin e nevojshëm. Mos i tregoni dikujt që nuk mund ti vijë në ndihmë personit që ka përjetuar DhBGj.
- Qëndroni të qetë dhe mos mbi reagoni si pasojë e asaj që dëgjoni
- Dëgjoni hapur duke mos qënë paragjykes ndaj historisë që dëgjoni
- Udhëzoni viktimët që të marrë ndihmë profesionale. Nëse ju nuk keni dijeni atëherë mundohuni të gjeni informacionin e nevojshëm se ku mund të drejtoheni.

Ku mund të drejtoheni për ndihmë?

Shpesh mund të ndodh që një person mund të jetë i papërgatitur se ku mund të drejtohet për ndihmë në raste se është viktimë apo dëshmitar i dhunës me bazë gjinore. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm është RAPORTIMI!

Në kontekstin Shqipëtar ka disa institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile të cilat marrin referime për rastet e dhunës me bazë gjinore por në të njëjtën kohë edhe ofrojnë ndihmë të specializuar.

Mekanizmi i parë që një person viktimë apo dëshmitar i DhBGj është policia e shtetit. Ku insitucion ofron gjithmonë, në 24 orë të ditës numrin e raportimit 112 ose 129. Çdo viktimë e DhBGj mund të raportojë në këtë numër por veçanërisht është e rëndësishme të raportohet në ato raste urgjente kur një person mund të jetë rezikuar edhe jetën.

Në vendin tonë ekzistojnë dy linja këshillimi të cilat punojnë 24 orë dhe janë të specializuara të presin rastet e dhunës.

1. Linja e këshillimit për Gra dhe Vajza në numrin 116 117. Ky mekanizëm ofrojnë këshillim telefonik si dhe këshillim ballë për ballë për qindra gra çdo vit. Kjo linjë ofron këshillim psikologjik dhe ligjor falas, me qellim fuqizimin dhe mbështetjen e grave që janë viktima të dhunës.

2. Linja e këshillimit për Fëmijë në numrin 116 111. Kjo linjë këshillimi është e specializuar në ofrimin e ndihmës psikologjike nëpërmjet telefoni për fëmijët dhe adoleshentët nën moshën 18 vjeçare. Linjat e këshillimit janë një hap i hapë nga ku mund të merret informacion por edhe të hapet rruga e mëtejshme e marrjes së shërbimeve në mënyrë të drejtpërdrejtë.

AKTIVITETE PRAKTIKE

METODA TE EDUKIMIT JO FORMAL

Pjesa e dytë e këtij manual sjell disa metoda te edukimit jo-formal të cilat mund të përdoren në aktivitete me të rinjtë në trajnim të çështjeve të dhunës me bazë gjinore. Këto aktivitete vijnë si një sugjerim, por sigurisht mund të përshaten në varsi të kontekstit, grupit, kohës dhe hapsirës që keni në dispozicion.

Historia e emrit tim

Tema: Marëdhënia me emrin e vet, përemrat.

Qëllimi: Të njiheni me njëri-tjetrin.

Jepni mundësi pjesëmarrësve të deklarojnë në mënyrë të qartë se cilin përemër dëshirojnë të përdorin kur iu referohen atyre.

Audienca që synohet:

Mund të praktikohet në kampet vullnetare, në seminare, në trajnime, në trajnime për koordinatorët e kampeve, në trajnime para nisjes etj., si dhe në shkolla ose me grupe të tjera të interesuara.

Koha e përcaktuar: 30 - 45 min

Metoda: Të ndajmë së bashku

Materialet e nevojshme: Postera me pyetje

Aktiviteti kryesor: 30 - 40 min

Vendosni një poster në mur me pyetjet e mëposhtme:

"Historia e emrit tim:

Cilat eksperiencia lidhen me emrin tuaj?

A munden zakonisht njerëzit të shqiptojnë emrin tënd?

Cfarë do të thotë emri yt?

Çfarë përemër duhet të përdoret për t'ju drejtuar juve?

A mund të përkthehet emri juaj në një gjuhë tjetër?

A ju pëlqen emri juaj?

A keni ndonjë pseudonim?

Kush ua ka vënë emrin ?

Mund edhe t'i hiqni 2/3 e pyetjeve të sipërme, nëse dëshironi. Shënim: Shpesh kjo lojë përfshin pyetje si:

"Kush e zgjodhi emrin për ju dhe pse?" / "A e keni ndryshuar ndonjëherë emrin tuaj?"

Ne rekomandojmë që të mos përdoren këto pyetje pasi disa njerëz, p.sh. transgjinator, i vendosin në pozicione të vështira të cilët mund të detyrohen të shpjegojnë apo të gënjejnë për historinë e tyre duke dalë në një pikë kur ata nuk duan ta bëjnë këtë.

Shpjegojini pjesëmarrësve se tani do të ndajnë me njëri-tjetrin historinë dhe përvojat e përditshme të emrave të tyre, duke iu përgjigjur pyetjeve në poster. Duke u bazuar në numrin e pjesëmarrësve që ka grupi ju mund të zgjidhni nëse ndarja e historive dhe përvojave do të bëhet në grupe më të vogla prej 3 ose 4 ose në seancë plenare. Nëse ka më shumë se 8 pjesëmarrës, ju sugjerojmë ta bëni atë në grupe më të vogla, përndryshe merr shumë kohë.

Nëse pjesëmarrësit ndahen në grupe më të vogla bëjnë një raund përfundimtar në seancë plenare ku njerëzit mund të ndajnë një histori ose eksperincë për secilin person.

Meqë ky është një aktivitet për tu njohur me njëri-tjetrin, nuk ka nevojë për reflektim, por sigurohuni që të theksoni rëndësinë e respektimit dhe përdorimit të përemrave të njerëzve në mënyrën se si ata aplikojnë dhe i përfaqëson ata më së shumti. Aktiviteti mund të kombinohet me një punëtori për ndjeshmërinë dhe respektin në një hapësirë të sigurt, pasi përqendrohet në përvojat personale dhe dëgjimin.

Portrete

Tema: Te njohim njëri-tjetrit, përemrat

Audienca e synuar: mund të bëhet kudo me grupet që sapo janë takuar

Madhësia e grupit: minimumi 8 persona

Koha e përcaktuar: 25 minuta

Metoda: vizatim

Materialet e nevojshme: një letër për person dhe stilolapsa ose lapsa me ngjyra. Një karrige ose jastëk për pjesëmarrësit.

Pjesëmarrësit do të ulen para njëri-tjetrit në çifte duke bërë një rreth (gjysma e grupit të bëjë një rreth që del përpara, gjysma tjetër bën një rreth të jashtëm, secili përballet me dikë). Shpërndani nga një letër dhe një stilolaps për secilin pjesëmarrës.

Kërkojuni secilit pjesëmarrës të shkruajë emrin e personit që kanë përballë në krye të letrës.

Aktiviteti kryesor: 15 min

Kërkojuni të gjithë pjesëmarrësve të vizatojnë formën e fytyrës së personit para tyre. Pas kësaj, u kërkonit atyre të shkëmbejnë letrën me partnerin e tyre (kështu që secili pjesëmarrës do të ketë përpara fytyrën e vetë të vizatuar) dhe grupi në rrethin e jashtëm ulen në një vend në të djathtë.

Kërkojuni të shkëmbejnë përsëri vizatimet me partnerin e tyre të ri dhe të vizatojnë sytë. Shkëmbejnë vizatimet përsëri. Pas çdo pjese që do të vizatojnë pjesëmarrësit i japin njëri-tjetrit dokumentet e tyre prapa dhe rrethi i jashtëm lëviz një në të djathtë. Do të

vizatohen gjërat e mëposhtme:

- Hundë ;Gojën; Veshët; Flokët; Çfarëdo që ju ndjeni, apo që mungon.

Reflektim: 5 min

Ju mund ta përdorni këtë për t'i mbajtur ato në mur dhe shkruani përemrat e tyre pranë fytyrave pas seancës së përemrave.

Hapësirat gjinore dhe normativitetet

Tema: Normativiteti, hapësira gjinore, privilegjet dhe dhuna gjinore.

Audienca e synuar: Mund të bëhet në seminare dhe trajnime gjinore, por edhe në kampet vullnetare ose me grupe të tjera që nuk janë shumë të njohura me temën gjinore, por marrin në konsideratë ndryshimin e pyetjeve në mënyrë që ata të përshtaten më mirë në këto mjedise të ndryshme.

Madhësia e grupit: minimum 10-12 pjesëmarrës.

Koha e përcaktuar: 90 minuta

Metoda: Kafja botërore

Materialet e nevojshme: të paktën 4 karta dhe dhoma të ndryshme ose një hapësirë të madhe. Mos u mundoni ta bëni këtë metodë vetëm, pasi keni nevojë të paktën për 4 persona që t'ju ndihmojnë të shkruani në çdo tabelë.

Çfarë duhet të dini: kjo metodë duhet të përdoret në grupe që tashmë janë të njohura me temën gjinore, ose pyetjet duhet të përshtaten për grupet me pak përvojë.

Përgatitja:

Përpara aktivitetit: Përgatisni 4

tabela të mëdha me pyetjet e mëposhtme në mes:

1. Cilat janë normat / normativiteti? Si mund të dëmtohen normat? Cilat norma na ndikojnë ne?
2. Cilat janë hapësirat gjinore? Shembuj? Pse ato ekzistojnë dhe si krijohen?
3. Si ndikojnë privilegjet në mënyrën se si e shohim / e perceptojmë botën? Cilat janë privilegjet tuaja?
4. Gjinia dhe dhuna, cila është lidhja? A të çojnë stereotipet në dhunë? Termat, gjuha? Për secilën nga tavolinat gjeni një mikpritës dhe i shpjegoni atyre se ata do të fokusohen në një temë, do të marrin shënimet në tabelë dhe do t'i shpjegojnë çdo grupi të ri atë që është diskutuar në raundin e mëparshëm.

4. Gjinia dhe dhuna, cila është lidhja? A të çojnë stereotipet në dhunë? Termat, gjuha?

Për secilën nga tavolinat gjeni një mikpritës dhe i shpjegoni atyre se ata do të fokusohen në një temë, do të marrin shënime në tabelë dhe do t'i shpjegojnë çdo grupi të ri atë që është diskutuar në raundin e mëparshëm.

Hyrje: 5 min

Ndani pjesëmarrësit në katër grupe dhe u shpjegoni atyre se ata do të duhet të shkojnë në dhoma ose hapësira të ndryshme ku do të punojë gjithmonë për një temë, për 10 minuta, duke mbajtur shënime mbi tabelat.

Aktiviteti

kryesor: 50 min

Pas çdo 10 minutash, secili grup shkon

në një tavolinë me një temë tjetër dhe mikëpritësi i secilës tryezë shpjegon atë që është diskutuar më parë. Në këtë mënyrë ata mund të mbështeten në diskutimet e mëparshme.

Reflektim: 10 min

Pas aktivitetit kryesor, kthehuni në grup sebashku dhe permbliidhni idet kryesore.

Barometri

Koha: 30m minuta

Madhësia e grupit: cilado madhësi

Pergatija: Krijoni një hapsirë nga 1 në 10, 1 = nuk pajtohem dhe 10 = pajtohem plotësisht. Trajnerët do të lexojnë disa deklaratat nga një dhe pjesëmarrësit mund të pozicionohen në çdo numër të barometrit sipas besimit dhe mendimeve të tyre.

Disa nga frazat seksuale janë:

- Vajzat mund të zgjedhin të punojnë dhe të bëjnë çdo gjë që është e rëndësishme për to;
- Gratë kanë lindur për t'u shërbyer burrave dhe fëmijëve;
- Nje burrë i mirë duhet të sjell më shumë të ardhura në shtëpi se gruaja e tij;
- Gratë edhe vajzat mund të bëjnë atë që duan, për sa kohë darken e lënë gati;
- Burri koka, gruaj qafa;
- Pas një burri të suksesshëm qëndron një grua e sukseshme;
- Nuk kam dëgjuar asnjëherë për gjuhën e urrejtjes;
- - Nuk kam përdorur kurrë gjuhë urrejtje
- Pas secilës shprehje pyesni rreth 3 apo 4 pjesëmarrës që janë të pozicionuar në vende të ndryshme përse janë aty dhe cfarë mendojnë.

Imagjinata

TKohëzgjatja: 90 minuta

Madhësia e grupit: Mbi 10 pjesëmarrës

Imagjino, ti zgjohesh në mëngjes dhe kur hyn në tualet zbulon se për disa arsye misterioze ti je shndërruar nga femër në mashkull dhe e kundërta. Ti nuk e di se për sa kohë do zgjasë ky transformim.

Diskutim

1- Cfarë do të bëje ?

2- Si do ta përshtasje sjelljen tënde në ambiente të ndryshme ?

3- Cfarë gjërash do të bëje ndryshe që si bëje dot në gjendjen tënde normale?

4- Cfarë të lejon ky transformim të bësh ndryshe ?

Akrim

Pjesëmarrësit

të ndarë në grupe prej 4-5 personash do të paraqesin situatën në Role Play , se si do të silleshin ata pas transformimit në :

A- Shtëpi

B - Palestër

C- Shkollë

D- Plazh

C- Festë

Diskutim

1- Çfarë të pëlqeu më shumë në situatën e krijuar ?

2- Të pëlqeu të ishe në këpucet e tjetrit?


3- Do të doje të qëndroje në këtë transformim përherë ? Pse , pse jo?



MESAZHE NGA TE RINJTE

DREJTUAR

VIKTIMAVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE BASHKËMOSHATARËVE DHE INSTITUCIONEVE PËRGEGJËSE



**TI NGRE ZËRIN SEPSE
DHIMBJET E TUA DUHET TË
MBAROJNË DHE TI DUHET
TË JETOSH!**

MEGI




**TI NGRIJE ZËRIN
SEPSE KE TË DREJTË TË
JETOSH ME RESPEKT
DHE DINJITET!**

ELIDA




**TI NGRIJE ZËRIN SEPSE
KE TË DREJTË!**

LAVDËRIM



**TI NGRIJE ZËRIN SEPSE
MERITON TË ARDHME TË
DENJË E TË LUMTUR!**

GREJD




**TI NGRIJE ZËRIN SEPSE...
EDHE NË QOFTE SE E GJITHË
BOTA HESHT, ZËRI YT I
BUKUR QË FLET TË
VËRTETËN ËSHTË HAPI I
PARË DREJT LIRISË!**

ALISJA




**TI NGRE ZËRIN SEPSE KE
VETËM NJË JETË DHE NUK
KE KOHË PËR TË HUMBUR!**

STENALDO




**DUKE NGRITUR ZËRIN SOT,
TI NESËR MUND TË JESH
NJË FRYMËZIM DHE FORCË
PËR SHUMË TË TJERË!**

GERALD



**TI NGRIJE ZËRIN KUNDËR
DHUNËS SEPSE TË NGRESH
ZËRIN SOT BËHET KULTURË
PËR BREZAT E ARDHSHËM!**

EMRA



**TI NGRE ZËRIN KUNDËR
DHUNËS SEPSE NUK JE
OBJEKT KONTROLLI!**

ANA



**TI NGRIJE ZËRIN SEPSE
JETA JOTE VLEN!**

ALMA